

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Gyltene Sylejmani dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Xh. D., nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson Z. G., kundër të paditurit N. Ll., nga Komuna e Prishtinës, me vendbanim në ..., Republika e Serbisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D. Ll., avokat nga ..., për shkak të vërtetimit të pronësisë, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3529/13 datë 31.1.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 28.8.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3529/13 datë 31.1.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3529/13 datë 31.1.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1832/06 datë 2.4.2013, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi është pronar i palujtshmërive të regjistruara si ngastra nr. ..., vendi i quajtur ..., me kulturë livadh, kl. 4, në sipërfaqe prej 0.41,25 ha, ngastra kadastrale nr. ..., vendi i quajtur ..., me kulturë mal, kl. 3, në sipërfaqe prej 3.44.04 ha dhe ngastra kadastrale ..., vendi i quajtur ..., me kulturë greminë kl.0, në sipërfaqe prej 0.06,81 ha, të gjitha të evidentuara sipas fletës poseduese nr..., KK ..., dhe të detyrohet i padituri që paditësit t’ia njohë të drejtën e pronësisë mbi këtë palujtshmëri. Me pjesën II të dispozitivit është lënë jashtë fuqie masa e sigurimit e caktuar me aktvendimin E.nr.1304/06 datë 18.4.2007. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar paditësi që të paditurit t’ia kompensoi shpenzimet e procedurës në shumë prej 987 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur, sipas dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës dhe konstatimi i ekspertit të gjeodezisë Q. H. del se ngastrat kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 0.41,25 ha, ngastra nr..., në sipërfaqe prej 3.44,04 ha dhe ngastra kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 0.06,81 ha, të cilat gjinden në vendin e quajtur ..., fleta poseduese nr. ..., zona kadastrale ..., Komuna e Prishtinës, evidentohen prona të Ll. (C.) N., ndërsa, gjendja faktike në teren përputhet me gjendjen në planet kadastrale të punuara sipas matjeve aerofotogrametrike të vitit 1972, të plotëfuqishme nga fillimi i vitit 1978 dhe të cilat janë valide edhe tani. Në ngastrën kadastrale nr ... ka pas të mbjella fidane të pemëve, ndërsa dy ngastrat tjera janë mal me drunjt mesatar.

Paditësi me padi ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar i palujtshmërive të cekura më lartë, nga fakti se me kontratën mbi shitblerjen të datës ..., të njëjtat i ka blerë nga i padituri.

Mbështetur në këtë gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë, ka konkluduar se paditësi nuk mund të fitojë të drejtën e pronësisë në bazë të kontratës interne të datës ..., për të cilën nuk është respektuar forma e paraparë sipas nenit 4 par . 2 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, i cili ka qenë në fuqi në kohën e arritjes së kësaj para kontrate, dhe pastaj ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke cekur se nuk janë plotësuar kushtet që paditësit t'i njihet e drejta e pronësisë, në palujtshmërinë lëndore, siç kërkohet me dispozitat e neneve 20, 28 par.2 të LTHMPJ –ës dhe nenit 4 par.2 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, andaj ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët, në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, se aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje thelbësore të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, se gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykata e shkallës së dytë drejt e ka zbatuar të drejtën materiale, kur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për çka ka dhënë arsye, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Thëniet e revizionit të paditësit se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga neni 182 par. 2 të LPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimin të kundërshtuar është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe me shkresat e lëndës, në aktgjykimin e kundërshtuar janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet juridikisht të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, duke nxjerrë konkludime të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo Gjykatë. Në revizion përveç që është cituar dispozita ligjore e cekur më lartë nuk është theksuar asnjë pretendim konkret se ku qëndrojnë shkeljet e pretenduara, në cilën pjesë të aktgjykimin apo cilat fakte nuk i kanë arsyetuar gjykatat e instancës më të ulët, e të cilat do të ndikonin në ligjshmërinë e aktgjykimin të kundërshtuar.

Pretendimin e cekur në revizion se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë dhënë arsye të mjaftuara se ku qëndron arsyeja e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, dhe nuk është e mjaftueshme vetëm referimi i dispozitave të ligjit material, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën ligjore nga neni 4 par. 2 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, i cili ka qenë në fuqi në kohën e arritjes së kësaj para kontrate, në të cilin është përcaktuar se kontrata për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme duhet të lidhet në formën me shkrim dhe të vërtetohet te organi kompetent, çka në rastin konkret nuk është vepruar, andaj me

të drejt gjykatat kanë konstatuar se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet thelbësore për lidhjen e kontratës në kuptim të nenit 26 të LMD –ës.

Gjykatat e instancës më të ulët kanë arsyetuar pretendimet e paraqitura nga paditësi se paluajtshmerinë kontestuese e ka fituar në bazë të parashkrimit fitues dhe se puna juridike e lidhur në mes të ndërgjyqësve është konvaliduar, por nga kjo Gjykatë u vlerësua se arsyetimi i gjykatave të instancës më të ulët lidhur me këtë pretendim, është i drejt dhe i bazuar në ligj, nga fakti se neni 28 par. 2 i LTHMPJ parasheh mbajtjen me mirëbesim të paluajtshmerisë kontestuese, ndërsa gjykata ka vërtetuar se paditësi nuk është në posedim të ngastrave kontestuese dhe sikur të ishte , do të ishte me keqbesim, si dhe nuk është vërtetuar se në mesë palëve është lidhur puna e vlefshme juridike dhe palët nuk kanë hyrë në raporte detyrimore që të përmbushin prestatimet obligatorë në mes veti, andaj në këtë rast nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 73 i LMD –ës për konvalidimin e kontratës, andaj gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se pretendimi i cekur në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të drejtës materiale është i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës , pretendimin e paditësit lidhur me shpenzimet e procedurës e vlerësoi si të pabazuar, ngase gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë vendosur kur paditësin e kanë obliguar që të paditurit t’ia kompensoi shpenzimet e procedurës, ngase me nenin 452 par.1 të LPK –ës është paraparë se pala e cila humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare t’ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore.

Nga sa u tha më lartë , e në bazë të nenit 222 të LPK –ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.212/2018 datë 28.8.2018

Kryetarja e kolegjit
Emine Kaçiku

